



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.05.2023 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-02240-1 në Zonën Kadastrale Rahovec

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/567/23 i datës 10.05.2023 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-02240-1, në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej 10000m² (dhjetmijë metra katror), nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7577401m² (shtatë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e një metra katror) në vendin e quajtur Shume-kabilja glava, me kulturë mal i klasës 5, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të P.SH.E KOSOVES K.K.RAHOVEC SHF.EKO.E PYJ. RAHOVEC.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Këmbimi i pronës komunale me pronën e institucionit qendror".
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.82/23
Datë:30.05.2023

